

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

**Në kërkim të zgjidhjeve të qëndrueshme për personat
e zhvendosur në qendrat kolektive në komunën e
Štrpce/Shtërpçës**

Mars, 2010

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
1. PASQYRË E PËRGJITHSHME	3
2. NË KËRKIM TË ZGJIDHJEVE TË QËNDRUESHME	5
Çështjet dhe shqetësimet e menjëhershme	6
<i>Përgatitja e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike</i>	<i>6</i>
<i>Energjia elektrike</i>	<i>7</i>
<i>Faturat për shërbime komunale dhe tatimi në pronë gjatë kohës së zhvendosjes ...</i>	<i>7</i>
<i>Kriteret për kualifikim për strehim social</i>	<i>7</i>
<i>Mirëmbajtja e qendrave kolektive</i>	<i>8</i>
3. ROLI I BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE	8
4. PËRFUNDIME	9
5. REKOMANDIME	10

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rreth 700 serbë të Kosovës dhe refugjatë serbë nga Kroacia janë të zhvendosur në komunën e Štrpce/Shtërpçës. Shumica e të zhvendosurve kërkuan strehim aty nga komunat fqinje të Ferizajt/Uroševac dhe Prizrenit gjatë konfliktit të vitit 1999, kurse të tjerët u zhvendosën pas trazirave në mars të vitit 2004. Pesë qendra kolektive, pushimoret shoqërore dhe format private të banimit ofrojnë strehim për këtë komunitet të cenuar që në shumë raste vazhdon të jetojë në kushte jashtëzakonisht të mjera.

Deri më tani, akterët vendorë dhe ndërkombëtarë në Kosovë dhe autoritetet në Beograd kanë bërë shumë pak për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur në Štrpce/Shtërpçë. Vetëm tani vonë, autoritetet u zotuan të ndajnë fonde për një kompleks të banimit social për strehimin e familjeve më të cënueshme, ku, në situatën ideale, do të përfshiheshin familjet e zhvendosura që strehohen në qendrat kolektive në komunë. Autoritetet komunale që buruan nga zgjedhjet lokale të Serbisë më 11 maj 2008 morën rolin udhëheqës duke e miratuar një plan lokal të veprimit, me përkrahje nga Komisariati për refugjatë i Serbisë (KRS), që parasheh ndërtimin e 24 banesave për familjet e zhvendosura/refugjate më të cënueshme. KRS u siguron ushqim banorëve të qendrave kolektive. Ndihma tjetër *ad hoc* ofrohet kryesisht nga Zyra e Komisionarit të lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatë (UNHCR) dhe nga organizatat joqeveritare.

Angazhimi për t'i përmirësuar kushtet e jetës së personave të zhvendosur dhe refugjatëve në vendin ku janë të zhvendosur nuk duhet të shihet medoemos si heqje dorë nga procesi i kthimit. Ai do të ofrojë së paku kushte më të denja të jetës për personat e zhvendosur gjatë kohës sa janë të zhvendosur, apo do t'u ofrojë atyre një mundësi për t'u integruar më mirë në vendin ku janë të zhvendosur. Në mënyrë që të ushtrohet e drejta për ta zgjedhur një zgjidhje të qëndrueshme, kërkohet që në dispozicion të jenë opsione të ndryshme (kthimi, integrimi lokal, vendosja diku tjetër).¹ Përfundimisht, personat e zhvendosur kanë nevojë për një platformë të përbashkët nga e cila do t'i promovonin interesat e tyre, kurse autoritetet duhet të fillojnë të merren seriozisht me gjendjen e vështirë të personave të zhvendosur duke i përmirësuar kushtet e tyre të jetës dhe duke i ndihmuar ata nëse dëshirojnë të integrohen në atë vend, të kthehen në vendet e tyre të prejardhjes apo të vendosen diku tjetër.

¹ Parimi 28(1) i Parimeve udhëzuese për zhvendosjen e brendshme (UN Doc. E/CN.4/1998/53/Add.2, Annex). Parimet bazohen në të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe i pasqyrojnë dhe janë në pajtim me to.

1. PASQYRË E PËRGJITHSHME

Komuna e Štrpce/Shtërpçës, e banuar me shumicë serbe, strehon numrin më të madh të personave të zhvendosur në rajonin e Gjilanit.² Vlerësohet që më shumë se 700 serbë të Kosovës³ dhe refugjatë serbë nga Kroacia⁴ janë të zhvendosur në këtë komunë. Pesë qendra kolektive, pushimoret shoqërore dhe format private të banimit ofrojnë strehim për këtë komunitet të cenuar. Gjithsej 253 të zhvendosur qëndrojnë në qendra kolektive që financohen nga KRS.⁵ Gjithashtu, 35 persona të zhvendosur kanë gjetur strehim në pushimore shoqërore. Të tjerët, gjithsej 491, banojnë me qira, qëndrojnë te të afërmit apo shokët, ose u është dhënë strehim privat dytësor.

Personat e zhvendosur të strehuar në komunën e Štrpce/Shtërpçës⁶

Strehimi	Personat e zhvendosur serbë të Kosovës ⁷
Qendra kolektive Tresnja	15
Qendra kolektive Elektrokosovo	29
Qendra kolektive Lahor	119
Qendra kolektive Junior	84
Qendra kolektive Elektrokosovo 2	6
Pushimore shoqërore ⁸ në Brezovica/Brezovicë & zgjidhje tjera	35
Me qira	203
Te të afërmit/shokët	76
Strehim privat (dytësor)	156
Gjithsej	723

² Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane janë 1442 persona të zhvendosur (Pasqyrë statistikore, UNHCR, Prishtinë/Priština, shkurt 2009). Rajoni përbëhet nga komuna e Ferizajt/Uroševac, Gjilanit/Gnjilane, Hanit të Elezit/Đeneral Janković, Kačanikut/Kaçanik, Kamenicës/Kamenica, Novobërdës/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçës, Vitisë/Vitina, dhe nga dy komunat e reja të Klokot/Kllokotit dhe Ranilug/Ranillugut.

³ ‘Analizë e situatës së PZhBV-K brenda ZP-së së Gjilanit/Gnjilane,’ UNHCR, shtator 2007. Në anën tjetër, KRS (2009) pohon që në komunën e Štrpce/Shtërpçës janë 785 persona të zhvendosur.

⁴ Refugjatët serbë nga Kroacia janë duke jetuar në komunën e Štrpce/Shtërpçës prej vitit 1995.

⁵ Qendrat kolektive dhe pushimoret shoqërore që përmenden në këtë raport gjenden në Brezovica/Brezovicë.

⁶ ‘Analizë e situatës së personave të zhvendosur brenda vendit të Kosovës (PZhBV-K) brenda Zonës së përgjegjësisë (ZP) së Gjilanit/Gnjilane,’ UNHCR, shtator 2007.

⁷ Në të dhëna janë përfshirë 11 refugjatë serbë nga Kroacia.

⁸ UNHCR u referohet këtyre si “shtëpi të braktisura” dhe lokale “të banuara”. Analiza e situatës së PZhBV-K brenda ZP-së së Gjilanit/Gnjilane, UNHCR, shtator 2007.

Shumica e personave të zhvendosur kanë kërkuar strehim në Štrpce/Shtërpçë nga komunat fqinje të Ferizajt/Uroševac dhe Prizrenit gjatë konfliktit të vitit 1999.⁹ Disa të tjerë u zhvendosën si rezultat i trazirave në mars të vitit 2004.

Në përgjithësi, kushtet e jetës në qendrat kolektive janë të kufizuara dhe mungojnë kushtet sanitare për t'i strehuar njerëzit për periudha të gjata kohore. Në "Lahor", qendrën më të madhe kolektive, ndodh që deri në tetë familje e ndajnë një tualet. Për më tepër, shumë persona të zhvendosur, kryesisht ata që strehohen në qendrat kolektive, nuk janë të punësuar dhe jetojnë në kushte mjaft të mjera, duke mbijetuar me ndihma sociale dhe pensione minimale. Shumë të tjerë i pret papunësia dhe kjo vlen posaçërisht për të punësuarit në ndërmarrje shoqërore që do të privatizohen. KSR u siguron ushqim banorëve të qendrave kolektive dhe pushimoreve shoqërore.¹⁰

Personat e zhvendosur shfrytëzojnë kryesisht shërbimet publike që i ofrojnë autoritetet komunale nga zgjedhjet lokale të Serbisë më 11 maj 2008, dhe më pak ato që i ofrojnë autoritetet komunale të Kosovës. Ata gjithashtu kanë qasje në shtëpinë e shëndetit në qendër. Megjithatë, ata që jetojnë në qendrat kolektive e kanë kryesisht vështirë të kenë qasje në këto shërbime për shkak të largësisë së qendrave kolektive dhe mungesës së transportit publik.

Ndarja e personave të zhvendosur dhe refugjatëve në komunën e Štrpce/Shtërpçës sipas profesionit¹¹	
Fëmijë të moshës parashkollore	0 %
Fëmijë të moshës shkollore (7-18 vjeçar)	12 %
Studentë (pas arsimit të mesëm)	9 %
Të punësuar	32 %
Të papunë	35 %
Pensionistë	12 %

Deri më tani, shumica e personave të zhvendosur i kanë shitur pronat e tyre në vendet e tyre të prejardhjes pasi që i kanë humbur shpresat për kthim të qëndrueshëm.¹² Shumë të tjerë i pohuan Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

⁹ Disa të tjerë u zhvendosën nga komuna e Prishtinës/Priština dhe Suharekës/Suva Reka.

¹⁰ Personat e zhvendosur, megjithatë, kanë raportuar që ndihmat për qendrat kolektive janë pakësuar në masë të konsiderueshme prej janarit të vitit 2009.

¹¹ Të dhënat e ofruara nga autoritetet komunale që buruan nga zgjedhjet lokale të Serbisë më 11 maj 2008.

¹² Vlerësohet që pothuajse gjysma e serbëve të Kosovës që dikur kanë jetuar në qytetin e Ferizajt/Uroševac tashmë i kanë shitur zyrtarisht shtëpitë e tyre. Në qytetin e Ferizajt/Uroševac dikur kanë jetuar pak më shumë se 5,000 serbë të Kosovës (sipas të dhënave të UNHCR). Të dhënat vetëm nga Gjykata komunale në Ferizaj/Uroševac tregojnë që 433 serbë të Kosovës i kanë shitur shtëpitë e tyre në qytet mes viteve 2001 dhe 2007. Prandaj, është e arsyeshme të supozohet që gati gjysma e tyre i kishin shitur zyrtarisht shtëpitë e tyre në qytet deri në atë kohë (sipas regjistrimit të popullsisë të Jugosllavisë të vitit 1991, secila familje në Ferizaj/Uroševac përbëhej nga 6.68 anëtarë). Megjithatë, nuk ka të dhëna që e pasqyrojnë numrin e vërtetë të kontratave joformale të shitblerjes, pjesë e rëndomtë e të cilave kanë qenë edhe transaksionet.

që ende nuk kanë qasje në shtëpitë e tyre. Ata konsiderojnë që kjo është për shkak të mungesës së zbatimit të vëmendshëm të ligjit nga ana e policisë së Kosovës përkitazi me largimin e uzurpuesve të paligjshëm në rastet kur ata rikthehen në shtëpitë e të zhvendosurve pas dëbimit (në këto raste, legjislacioni parasheh që policia mund t'i largojë uzurpuesit e paligjshëm sipas detyrës zyrtare).¹³ Shumë të tjerë, duke i përfshirë edhe të kthyerit, pohojnë që tokat e tyre bujqësore janë uzurpuar apo kanë frikë që të shkojnë në to pasi që nuk gjenden shumë afër shtëpive të tyre.¹⁴

2. NË KËRKIM TË ZGJIDHJEVE TË QËNDRUESHME

“Autoritetet kompetente e kanë detyrë dhe përgjegjësi primare që t’i krijojnë kushtet dhe t’i sigurojnë mjetet që ua mundësojnë personave të zhvendosur brenda vendit që të kthehen vullnetarisht, të sigurt dhe me dinjitet në shtëpitë dhe vendbanimet e tyre, ose të vendosen vullnetarisht në ndonjë pjesë tjetër të vendit.”¹⁵

Autoritetet lokale kanë bërë shumë pak për t’i nxitur personat e zhvendosur që të kthehen. Vetëm një numër i vogël i familjeve të zhvendosura serbe të Kosovës në Štrpce/Shtërpçë e kanë shprehur dëshirën të kthehen në komuna e tyre të prejardhjes.¹⁶ Shumica shpresojnë t’i shesin pronat e tyre dhe të largohen nga Kosova, derisa 21 për qind e shprehën dëshirën për t’u integruar me komunitetin lokal në vendin ku janë të zhvendosur.¹⁷ Ndonëse qëndrimi i Parimeve udhëzuese për zhvendosje të brendshme është “që duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për t’u siguruar rikthimi i bazuar në kthim [...]”, ato gjithashtu e njohin faktin që personat e zhvendosur “mund të mbështeten në zgjidhje të qëndrueshme të bazuar në kompensim përkitazi me zhvendosjen” nëse ata “e favorizojnë qartas” një opsion të tillë.¹⁸ Për më tepër, “[...] një periudhë e gjatë kohore ka [mund të ketë] kaluar prej zhvendosjes dhe të zhvendosurit e kanë ndërtuar jetën e tyre diku tjetër në atë mënyrë që nuk do të donin ta ndërrojnë vendin edhe nëse kushtet për kthim janë të sigurta.”¹⁹ Përkundër kësaj, vetëm një familje e zhvendosur është integruar në aspekt lokal në komunën e Štrpce/Shtërpçës përmes ndihmës për banim. Kjo familje e zhvendosur serbe e Kosovës, me origjinë nga komuna fqinje e Ferizajt/Uroševac, mori ndihmë për banim

¹³ Shih Raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë: “*Tetë vjet më pas. Kthimet e minoriteteve dhe rikthimet e pronës dhe pronës banesore në Kosovë.*”, qershor 2007. Për më tepër, Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale konsideron që policia “ka qenë e ngadalshme sa i përket dëbimeve të serishme” (Edward Tawil, “Të drejtat pronësore në Kosovë: Trashëgimi ndjekëse e një shoqërie në tranzicion”, Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale, shkurt 2009, faqet. 35-37).

¹⁴ Sidoqoftë, shumica e tyre, në mos të gjithë, nuk do të posedonin veglat bujqësore për t’i kultivuar arat e tyre. Komponentët e gjenerimit të të ardhurave për të kthyerit kanë paraparë rrallë skema të tilla gjithëpërfshirëse.

¹⁵ Parimi 28(1) i Parimeve udhëzuese për zhvendosjen e brendshme (UN Doc. E/CN.4/1998/53/Add.2, Annex).

¹⁶ Gjetjet bazohen në bisedat me 100 familje të zhvendosura serbe të Kosovës në Štrpce/Shtërpçë që i zhvilluan zyrtari komunal për kthim në vitin 2006. Forumet e personave të zhvendosur në Štrpce/Shtërpçë (që i organizuan bashkërisht OSBE dhe UNHCR në gjysmën e dytë të vitit 2009) i reflektojnë këto gjetje në atë që shumë pak persona besojnë në kthim të qëndrueshëm.

¹⁷ *Po aty.*

¹⁸ Doracak për rikthimin e pronës dhe pronës banesore për refugjatët dhe personat e zhvendosur: Zbatimi i “Parimeve të Pinheiro-s”, OKB, mars 2007, faqe 27.

¹⁹ *Po aty.*

në vitin 2009 për arsye se familja ishte pronare e një toke në Štrpce/Shtërpçë dhe fëmijët e tyre mund ta vijonin mësimin në një shkollë me planprogram të Serbisë në Štrpce/Shtërpçë.²⁰

Për më tepër, është bërë shumë pak për përmirësimin e kushteve të jetës së personave të zhvendosur dhe refugjatëve në Štrpce/Shtërpçë. Në fakt, autoritetet komunale të Kosovës nuk kanë ndërmarrë kurrfarë hapash për të ofruar ndonjë lloj ndihme duke u arsyetuar me mungesë të fondeve dhe duke ia lënë këtë çështje Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK). Në vitin 2009, MKK tregoi disa shenja të përkrahjes për personat e zhvendosur që kanë mbetur në qendrat kolektive. Megjithatë, këto plane nuk u shfaqën para vitit 2010, kur edhe u aprovuan përfundimisht fondet për ndërtimin e një kompleksi të banimit social në Štrpce/Shtërpçë. Është menduar që ky kompleks banimi t'i strehojë familjet më të cenueshme, duke përfshirë personat në ndihmë sociale, personat e zhvendosur dhe të rinjtë (kriteret e sakta të përzgjedhjes do të vendosen pasi të kenë filluar ndërtimet). Kjo nismë financohet nga Zyra për komunitete e Zyrës së Kryeministrit. Sipas planit, ndërtimi do të duhet të fillonte deri në gjysmën e dytë të vitit.²¹

Ishin organet që buruan nga zgjedhjet lokale të Serbisë të 11 majit 2008 ato që arritën të miratojnë planin lokal të veprimit më 20 tetor 2009, nën patronatin e KRS, më synim në përmirësimin e kushteve jetësore për shumicën e rasteve të cenueshme.²² Plani parasheh ndërtimin e dy ndërtesave me 24 banesa në Štrpce/Shtërpçë, të cilat do tu jepen në shfrytëzim shumicës së personave të cenueshëm të zhvendosur dhe familjeve të refugjatëve.²³ Tenderi për ndërtimin e ndërtesave pritet të fillojë në prill apo maj të vitit 2010.²⁴ Tanimë është blerë parcela e tokës për qëllime të realizimit të këtij projekti.²⁵

Çështjet dhe shqetësimet e menjëhershme

Përgatitja e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike

Qendrat kolektive, si dhe pushimoret në Štrpce/Shtërpçë në të cilat jetojnë personat e zhvendosur dhe refugjatët, janë të gjitha në pronësi shoqërore dhe duket se të gjitha do të privatizohen. Për këtë qëllim, autoritetet duhet të ndërmarrin veprime të veçanta për të siguruar ristirimin e personave të zhvendosur që aktualisht janë të strehuar në ndërmarrje shoqërore para se të bëhet çfarëdo forme e privatizimit. Megjithatë,

²⁰ Kjo familje u vendos në fshatin Gornja Bitinja/Biti e Epërme në vitin 2009. Fondet i aprovuan MKK, UNDP dhe UNHCR.

²¹ Kryetari i komunës së Štrpce/Shtërpçës konfirmoi vendimin për OSBE-në më 10 mars 2010. Kompleksi i banimit, sipas kryetarit të komunës, do të duhej të ofronte rreth 60 deri 70 banesa.

²² Plani lokal i veprimit i miratuar nga kuvendi komunal që buroi nga zgjedhjet lokale të Serbisë të 11 majit 2008 parasheh disa kriterë bazike për përzgjedhjen e përfituesve. Prioritet do të jenë: prindërit e vetëm, familjet me fëmijë të sëmurë, familjet me pjesëtarë të familjes të aftë për punë por të papunë, të moshuarit, personat me nevoja të veçanta dhe familjet e mëdha me pjesëtarë të disa gjeneratave. Sipas kryetarit komunal të zgjedhur në zgjedhjet lokale të Serbisë të 11 majit, financimi i këtyre projekteve mbështetet nga Bashkimi Evropian përmes KRS.

²³ Sipas informatave të përcjella për OSBE-në më 26 mars 2010 nga kryetari komunal i zgjedhur në zgjedhjet lokale të Serbisë të 11 majit.

²⁴ *Po aty*

²⁵ *Po aty*

Kryetari i sapo zgjedhur i komunës së Štrpce/Shtërpçës, ka siguruar se privatizimi i qendrave kolektive nuk pritet të ndodhë para vitit 2012/13.

Energjia elektrike

Qendrat kolektive në Štrpce/Shtërpçë kanë pranuar faturat e para të energjisë elektrike në nëntor 2009. Deri më tani, qendrat kolektive nuk kanë qenë në gjendje të paguajnë apo të gjejnë burime alternative për kryerjen e këtyre pagesave, përkundër sugjerimeve që Ministria e punës dhe mirëqenies sociale dhe/apo Ministria për komunitete dhe kthim mund t'u ofrojnë ndihmë. Çdo ndërprerje e zgjatur e energjisë elektrike, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit, mund të ketë pasoja të rënda shëndetësore për personat e zhvendosur. Më 20 shkurt 2010, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) njoftoi të gjitha qendrat kolektive në rajonin e Gjilanit /Gnjilane se ato duhet të fillojnë të paguajnë energjinë elektrike deri më 1 prill 2010.²⁶ KEK-u këshilloi që banorët e qendrave kolektive të kërkojnë sponsorë të ministritë relevante dhe organizatat ndërkombëtare. Po ashtu, këto njoftime u bëjnë thirrje banorëve që të nxisin udhëheqësit e qendrave kolektive të punojnë së bashku me Qendrat e Kosovës për mirëqenie sociale dhe të përfshijnë sa më shumë familje që është e mundur në skemat e ndihmës sociale, me çka do të mundësohej pagesa e një pjesë të faturave mujore. Megjithatë, shumë pak familje të zhvendosura kualifikohen për ndihmë sociale. Skema e ndihmës sociale nuk është gjithëpërfshirëse aq sa duhet për të përfshirë të gjitha familjet që vërtetë janë në nevojë, për shkak të kriterëve shumë të rrepta të cilat kanë lënë shumë familje pa mbështetje.

Faturat për shërbime komunale dhe tatimi në pronë gjatë kohës së zhvendosjes

Shumë persona të kthyer dhe të zhvendosur ankohen se kanë pranuar fatura të tatimit në pronë apo të energjisë elektrike për vendin e tyre të prejardhjes për kohën sa janë/ishin të zhvendosur.²⁷ Ministria për komunitete dhe kthim u zotua se do t'u lëshojë certifikata të cilat do t'i lironin të kthyerit nga pagesa e faturave për shërbime komunale për periudhën gjatë së cilës kanë qenë të zhvendosur. Megjithatë, Ministria e cekur ende nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për këtë qëllim.²⁸

Kriteret për kualifikim për strehim social

Shumë pak persona të zhvendosur në Štrpce/Shtërpçë do të kualifikoheshin për strehim social nëse kriteret e vendosura përfshijnë vetëm ata që kanë të drejtë në ndihmë sociale.²⁹ Sipas degës së Kryqit të Kuq serb në Štrpce/Shtërpçë, jo më shumë se 10 për qind e familjeve të zhvendosura në qendrat kolektive kualifikohen për

²⁶ Nuk është përmendur borxhi i rritur dhe nëse qendrat kolektive do të japin llogari për atë. Menaxheri rajonal i KEK-ut ka informuar OSBE-në në nëntor 2009, se qendrat kolektive nuk duhet të shqetësohen për borxhin e rritur.

²⁷ Duke supozuar se personat e zhvendosur nuk kishin qasje në pronën e tyre dhe nuk kanë marrë kurrfarë qiraje gjatë kohës së zhvendosjes.

²⁸ Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), UNHCR, KEK, MKK dhe Ministria e punës dhe mirëqenies sociale janë takuar dhe kanë marrë vendimin përkatës në korrik 2009.

²⁹ Një familje me një anëtar të aftë për punë (ndonëse të papunë) me së paku një fëmijë nën moshën pesë vjeçare është i kualifikueshëm në mbështetje (neni 4.1 Rregullorja e UNMIK-ut 2003/28 për Skemën e ndihmës sociale në Kosovë, 18 gusht 2003.) Familjet në ndihmë sociale po ashtu kanë të drejtë në subvencion deri në 20 euro në muaj për pagesën e energjisë elektrike (KEK-u nënshkruan marrëveshje me Ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale çdo vit ku përcaktohen personat e kualifikuar për subvencion dhe në çfarë niveli).

ndihmë sociale.³⁰ Gjithashtu, shumica e serbëve të Kosovës frikësohen se nisma e strehimit social do të shërbejë si mjet për strehimin e pjesëtarëve të popullatës së cenushme të komunitetit shumicë, siç janë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe/apo të afërmeve të tyre të cilët do të ndryshonin strukturën demografike në komunë. Sido që të jetë, duhet që para vendimit për themelimin e një kompleksi të banimit të kryhet një vlerësim gjithëpërfshirës dhe transparent i nevojave.

Mirëmbajtja e qendrave kolektive

Gjendja e dobët e qendrave kolektive është rezultat i shumë viteve të lënies pas dore. Kjo veçanërisht vlen për qendrën kolektive Lahor. Për shkak të mungesës së resurseve financiare, kulmi i saj nuk është mirëmbajtur dhe riparuar gjatë dhjetë viteve të fundit. Si rrjedhojë, në kulm gjenden vrima të mëdha të cilat lejojnë depërtimin e ajrit të ftohët, shiut, madje edhe borës, duke rrezikuar në këtë mënyrë jo vetëm komforin, por edhe shëndetin e banorëve të qendrës kolektive.³¹

3. ROLI I BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE

OSBE-ja vazhdimisht ka kërkuar fuqizimin e përqendrimit të saj në komunitet joshumicë me synim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe pjesëmarrjes së tyre efektive, duke paraqitur rekomandime, promovuar dialog dhe lehtësuar veprime përmirësuese.³² Në pajtim me moton e Ditës Botërore të Refugjatëve të UNHCR-së 2009 “Njerëz të vërtetë, nevoja të vërteta”, Qendra rajonale e OSBE-së në Gjilan/Gnjilane mori vendim që bashkë me UNHCR-në të themelojë Forume të personave të zhvendosur në dy qendrat më të mëdha kolektive, Lahor dhe Junior.³³ Forumet fillestare shërbyen si mundësi e mirë për t’i ngritur problemet me të cilat përballen personat e zhvendosur në baza ditore. Krahas çështjes emergjente të kthimit të qëndrueshëm, ofrimit të kushteve më të mira të banimit, si dhe ofrimit të energjisë elektrike, personat e zhvendosur ishin shumë të zëshëm duke kërkuar që të kenë transportim prej qendrave për në qytet, për t’iu mundësuar qasje në shtëpitë e shëndetit apo për t’iu mundësuar vizita të stafit mjekësor në qendër. Duke mos pasur zgjidhje para vetes, OSBE-ja kërkoi mënyra të sigurimit të transportimit si zgjidhje edhe për personat e zhvendosur që kanë nevojë për qasje në shtëpi të shëndetit dhe shërbime komunale. OSBE-ja arriti të gjejë zgjidhje përmes së cilës, shkolla e mesme “Jovan Cvijic”, në këmbim për goma të autobusëve për të gjitha sezonet, u pajtua që për personat e zhvendosur të sigurojë dhe të ofrojë në dispozicion një autobus, ngasës dhe karburant. Autobusi filloi shërbimet e tij më 29 tetor 2009 duke i mundësuar personave të zhvendosur qasje më të mirë në shërbimet në shërbime të ndryshme jetike, siç janë qasja në komunë, gjyqësor, qendra shëndetësore apo në bërje të pazarit. Forumet tani mbledhen çdo tre muaj dhe ato mundësojnë një

³⁰ Vlerësimi është kryer nga Kryqi i kuq në bashkëpunim me drejtorët e qendrave kolektive në Štrpce/Shtërpce, në fillim të muajit mars 2010.

³¹ Donatorët e mundshëm duket se janë duke e miratuar politikën “prit dhe shih”, duke qenë në njohuri të plotë se qendrat kolektive mund t’i nënshtrohen privatizimit dhe se një numër i konsiderueshëm i personave të zhvendosur duhet të presë strehimin në kompleksin e banimit të paraparë përmes planit të sipërpërmendur lokal. Kostoja e përafërme e riparimit të kulmit parashihet të jetë 16,356 euro.

³² Për qëllimi të këtij raporti, komunitetet joshumicë janë ato komunitete që përbëjnë pakicë numerike në nivel komunal në Kosovë.

³³ Forumet e para të personave të zhvendosur janë mbajtur në qershor/korrik 2009.

platformë në të cilën personat e zhvendosur në mënyrë efektive mund të artikulojnë interesat e tyre duke ndjekur zgjidhje reale.

Në përpjekje për të sjellë një ndjenjë të normalitetit për personat e zhvendosur të komunitetit serb në qendrat kolektive, OSBE-ja, në bashkëpunim të ngushtë me UNHCR-në, u ka ofruar atyre edhe pajisje rekreative, tabela të pingpongut, tavolina të bilardos, lodra të futbollit vogël, televizion, dhe DVD.³⁴ OSBE-ja po ashtu ka riparuar hollin e njëres nga qendrat më të mëdha kolektive, duke i ofruar personave të zhvendosur një vend për t'u mbledhur së bashku, shoqëruar, diskutuar shqetësimet e përbashkëta, si dhe për të mundësuar një vend të përshtatshëm për forume të personave të zhvendosur. Ndihamat tjera *ad-hoc* siç janë lënda djegëse për ngrohje, ushqimi, artikuj higjienikë, veshmbathje, shërbime ligjore, si dhe krijim të të ardhurave individuale janë ofruar kryesisht nga UNHCR-ja, por edhe nga organizatat joqeveritare dhe individët.³⁵ Dega e Kryqit të kuq serb në Štrpce/Shtërpçë bashkërendon shpërndarjen e ndihmës humanitare dhe mban regjistra të përditësuar për rastet më të cenueshme. UNHCR-ja, duke mëtuar gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme, ka organizuar disa vizita të nivelit të lartë të OKB-së në qendrat kolektive gjatë tërë vitit 2009.

4. PËRFUNDIME

Përpjekjet aktuale për përmirësimin e kushteve të jetës të personave të zhvendosur dhe refugjatëve në lokacionet e tyre të zhvendosjes, duke përfshirë ndërtimin e projektit të banimit për strehimin e personave të zhvendosur, nuk duhet të shihen si heqje dorë nga procesi i kthimit.³⁶ Projekti i banimit do të ofrojë standarde më të dinjitetshme të jetës për personat e zhvendosur gjatë periudhës së tyre në zhvendosje, apo do t'u mundësojë personave të zhvendosur opsionin që të integrohen më mirë në aspekt lokal. Vendimi eventual për t'u kthyer apo integruar në aspekt lokal duhet t'i takojë çdo personi të zhvendosur individualisht. Në ndërkohë, personat e zhvendosur kanë nevojë për një forum të përbashkët dhe funksional në të cilin do të përcaktojnë dhe promovojnë interesat e tyre dhe që përfundimisht të fitojnë mbështetje për gjendjen e tyre të vështirë. Për më tepër, personat e zhvendosur duhet të jenë tërësisht të informuar mbi të gjitha opsionet e kthimit (të organizuar, individual dhe spontan) dhe përparësitë dhe mangësitë e çdo opsioni, si dhe atë që i pret ata nëse kthehen. Po ashtu, në anën tjetër, autoritetet kompetente duhet të fillojnë ta marrin seriozisht gjendjen e vështirë të personave të zhvendosur duke përmirësuar kushtet e tyre të jetës dhe t'i ndihmojnë ata që dëshirojnë të integrohen në aspekt lokal duke mbajtur të gjallë edhe prospektin e kthimit.

³⁴ OSBE-ja nuk është organizatë donatore. Megjithatë, OSBE-ja ka realizuar projekte me ndikime të menjëhershme në nivel të ulët buxhetor, për të përmbushur një nevojë të menjëhershme apo për të bërë ndikim të menjëhershëm në një nevojë të identifikuar në mbështetje të aktiviteteve të Misionit.

³⁵ UNHCR-ja ofron shërbime ligjore përmes OJQ-së – Programi për të Drejtat Civile, Kosovë (PDC/K). Po ashtu, UNHCR-ja ofroj edhe projekte të Vetë-mbështetjes dhe Krijimit të të ardhurave.

³⁶ Raporti i përfaqësuesit të Sekretarit të përgjithshëm për të drejta të njeriut të personave të zhvendosur, Walter Kälin, Addendum, “Mbështetja e PZh në normalizimin e gjendjes së tyre të jetesës në lokacion të zhvendosjes (duke i ndihmuar atyre që të gjejnë punësim, shtëpi të tyre, etj.) nuk përjashton të drejtën në kthim”, Korniza për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur brenda vendit, A/HRC/13/21/Add.4, 29 dhjetor, f. 17.

5. REKOMANDIME

Për autoritetet kompetente, bashkësinë ndërkombëtare dhe organizatat që punojnë në kthime:

- Nevojat e personave të zhvendosur duhet të kenë prioritet të lartë, në mënyrë që të përmirësohen kushtet e tyre të jetës dhe të ndihmohen personat që dëshirojnë të integrohen në aspekt lokal;
- Të sigurohet se përdoren kritere transparente të përzgjedhjes gjatë vendosjes së të drejtës së kualifikimit për banim social, si dhe që më shumë persona të zhvendosur të cënueshëm të kenë prioritet (drejta vetëm në ndihmë sociale nuk duhet të parandalojë një familje të zhvendosur nga sigurimi i banimit social);
- Autoritetet relevante duhet të sigurojnë se personave të zhvendosur në qendrat kolektive u ofrohet energji elektrike pa ndërprerje, duke marrë parasysh faktin se vetëm ndihma sociale nuk do të jetë e mjaftueshme;
- Të sigurohet se të kthyerve dhe personave të zhvendosur nuk u dërgohen faturat për tatime në pronë apo të energjisë elektrike për vendet e tyre të prejardhjes për periudhën kohore gjatë së cilës ata ishin të zhvendosur;
- Të vlerësohet së në çfarë mase ekziston mungesa e zbatimit të duhur të ligjit nga ana e Policisë së Kosovës, siç është raportuar nga personat e zhvendosur, në lidhje me largimin e uzurpuesve të paligjshëm në rastet e riuzurpimit të shtëpive pas dëbimit;
- Të sigurojnë se personat e zhvendosur, nëse vendosin për një gjë të tillë, të kthehen në grupe në lagje të caktuara në qytezat/qytetet e tyre të prejardhjes, meqë shumica pretendojnë se është pritur të kthehen në lokacione të shpërndara, në kundërshtim me kërkesat e tyre.